



Oda e Stomatologëve të Kosovës  
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

**RREGULLORE PËR  
“REVISTËN E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS”**

Prishtinë, Shkurt 2025



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
**Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo**

**KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TE KOSOVËS (OSK)**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe në lidhje me Nenin 10, paragrafin 1 me nën-paragrafin 16 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë; Nenin 20, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1 dhe në lidhje me Nenin 16, paragrafin 1 me nën-paragrafin 16 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Republikës së Kosovës dhe Nenin 18, paragrafi 5 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OSK-së, në mbledhjen e rregullt më 22.02.2025, miraton këtë:

RREGULLORE PËR

“REVISTËN E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS - RSK”

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit të Kuvendit të OSK-së, të dt.22.02.2025 )

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJLTHSHME

Neni 1

1. Revista e Stomatologëve të Kosovës është organi zyrtar i Odës së Stomatologëve të Kosovës i themeluar nga Kuvendi i Odës për të promovuar dhe përhapur informacionin shkencor dhe profesional në fushën e stomatologjisë.

2. Emërtimi i revistës është Revista e Stomatologëve të Kosovës, shkurtesa “RSK” (në tekstin e mëtejme Revista).
3. Dimensionet e revistës janë 28cm x 21cm, ndërsa ngjyra e kopertinës të jetë e ndërlidhur me ngjyrën e logos zyrtare të Odës. Tipografia e titullit dhe tërë materialeve të revistës duhet të jetë e qartë, moderne dhe e lexueshme.
4. Botues i revistës është Kryetari i Odës sipas detyrës zyrtare.

## Neni 2

Revista synon të mbështesë avancimin e stomatologjisë në Kosovë dhe më gjerë, duke ofruar përmbajtje shkencore dhe profesionale të nivelit të lartë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat etike profesionale.

## Neni 3

Rregullorja për Revistën e Stomatologëve të Kosovës përcakton drejtimit dhe parimet e funksionimit të revistës, duke siguruar organizimin, menaxhimin dhe përmbajtjen e saj. Po ashtu, rregullorja definon detyrat dhe përgjegjësitë e redaksisë, si dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe shkencorë të jashtëm, për të siguruar që përmbajtja e revistës të jetë në përputhje me kërkesat dhe standardet profesionale dhe shkencore ndërkombëtare. Ajo përfshin rregulla të qarta për proceset editoriale, përzgjedhjen dhe shqyrtimin e artikujve, si dhe mbikëqyrjen e cilësisë shkencore të materialeve që publikohen.

## Neni 4

### Përkufizimet

1. Termet dhe shkurtesat e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:
  - 1.1 **Oda** – Oda e Stomatologëve të Kosovës
  - 1.2 **Këshilli Drejtues i Odës** - organ drejtues i Odës
  - 1.3 **Botuesi- Kryetari i Odës**
  - 1.4 **Redaksia** – grupi profesional për redaktim të artikujve
  - 1.5 **Kryeredaktori** – kryesuesi i Redaksisë
  - 1.6 **Sekretar i redaksisë** -organ administrativ i RSK-së
  - 1.7 **Autori** – personi që ka shkruar dorëshkrimin.
  - 1.8 **Dorëshkrimi** – materiali i hartuar nga autori.
  - 1.9 **Korrektimi** – përmirësimi i dorëshkrimit

- 1.10 **Bashkëpunëtori profesional dhe shkencor** – ekspert i angazhuar për vlerësimin e dorëshkrimeve
  - 1.11 **Numri** – numri i RSK-së sipas radhës së botimit
  - 1.12 **Portreti** – hapësira e veçantë në RSK me biografinë e profesionistit shëndetësor
  - 1.13 **Arkivimi** – ruajtja e numrave të botuar të Revistës në formë fizike dhe digjitale
  - 1.14 **Hapësira promovuese** – hapësira e veçantë e Revistës për marketing
  - 1.15 **Koordinatori** – zyrtari i shërbimit profesional të Odës.
2. Termet që nuk përkufizohen në Paragrafin 1 të këtij neni interpretohen sipas përkufizimeve gjuhësore dhe teknike-profesionale.

## **KAPITULLI II**

### **ORGANET DREJTUESE TË REVISTËS – DHE FUSHËVEPRIMI I TYRE**

#### **Neni 5**

##### **Këshilli Drejtues i Odës së Stomatologëve të Kosovës**

1. Këshilli Drejtues i Odës (në tekstin e mëtejme KD) ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së Revistës duke aprovuar dhe mbështetur strategjitë editoriale dhe organizative të saj.
2. Këshilli Drejtues me propozim të Kryetarit të OSK-së emëron redaksinë e revistës (në tekstin e mëtejme Redaksia).
3. Këshilli Drejtues mund të përfshijë figura kyçe nga fusha e stomatologjisë dhe të ofrojë mbështetje strategjike dhe financiare për revistën.

#### **Neni 6**

##### **Botuesi i Revistës**

1. Botuesi ka përgjegjësi kyçe për funksionimin dhe menaxhimin e revistës, duke siguruar që ajo të përmbushë objektivat e saj shkencore dhe profesionale.
2. Botuesi është përgjegjës për mbikëqyrjen e përzgjedhjes së artikujve dhe materialeve që do të botohen, duke siguruar që ato të jenë të saktë, të bazuara në kërkime shkencore dhe të përputhshme me standardet etike dhe profesionale.

3. Botuesi bashkëpunon ngushtë me kryeredaktorin, redaksinë dhe bashkëpunëtorët shkencorë për të përcaktuar tematika dhe për të siguruar që revista të jetë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e profesionistëve të stomatologjisë.
4. Botuesi është përgjegjës për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e politikave editoriale, si dhe për garantimin e një procesi të rregullt dhe transparent të recenzimit dhe miratimit të materialeve për botim.
5. Botuesi ka detyrën të promovojë revistën në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, të përfshijë temat e reja dhe aktuale, dhe të nxisë pjesëmarrjen e profesionistëve dhe shkencëtarëve në publikimin e artikujve.
6. Botuesi ka përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të revistës.

## **Neni 7**

### **Redaksia e Revistës**

1. Redaksia e revistës (në tekstin e mëtejme Redaksia) është përgjegjëse për zhvillimin e përmbajtjes së revistës, përzgjedhjen e artikujve dhe miratimin e materialeve që do të publikohet.
2. Redaksia përbëhet prej 10 (dhjetë) anëtarëve duke përfshirë, kryeredaktorin, zëvendëskryeredaktorin dhe sekretarin.
3. Anëtarët e redaksisë emërohen nga KD me propozim të Kryetarit të Odës.
4. Mandati i anëtarëve të redaksisë është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje edhe një mandat.
5. Nëse anëtari i redaksisë mungon në mbledhje të punës tri herë rradhazi pa arsytim, KD e bënë zëvendësimin e tij.
6. Kryeredaktori ka të drejtë të ftojë në mbledhje të Redaksisë edhe persona të tjerë me interes rreth Revistës.
7. Redaksia nxjerrë rregulloren e punës.
8. Selia e Redaksisë është në zyret e Odës.

## Neni 8

### Përgjegjësitë e Redaksisë

1. Redaksia i ka këto përgjegjësi:
  - 1.1 Cakton strukturën dhe përmbajtjen e Revistës.
  - 1.2 Zbaton procedurat për botimet e numrave të Revistës.
  - 1.3 Angazhohet në përzgjedhjen e temave të reja nga fusha e stomatologjisë.
  - 1.4 Shqyrton dhe aprovon dorëshkrimet për publikim në Revistë.
  - 1.5 Shqyrton dhe vendos për përshtatshmërinë e përmbajtjes së hapësirave promovuese.
  - 1.6 Redaktimin dhe përmirësimin i dorëshkrimeve të dorëzuara nga autorët.
  - 1.7 Mund të merret me rishikimin e stilit dhe gramatikës, përveç aspekteve shkencore dhe teknike të materialeve.
  - 1.8 Zbaton buxhetin e Odës lidhur me Revistën.

## Neni 9

### Kryeredaktori

1. Përgjegjësitë e kryeredaktorit janë:
  - 1.1 Është përgjegjës për udhëheqjen e redaksisë.
  - 1.2 Sëbashku me botuesin bën përzgjedhjen dhe miratimin e artikujve që do të publikohen.
  - 1.3 Siguron që Revista të ketë përmbajtje të lartë shkencore dhe profesionale,
  - 1.4 Komunikimi me autorët dhe redaktorët për përmirësimin e dorëshkrimeve të arritura.
  - 1.5 Ndhmon në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare të redaksisë.
  - 1.6 Sigurimi i të gjitha materialeve të dorëzohen dhe të shqyrtohen brenda afateve të caktuara.
  - 1.7 Përbushja e afateve kohore të daljes së numrave të Revistës dhe ruajtjen e cilësisë së revistës.

## Neni 10

### Zëvendës kryeredaktori

1. Zëvendës kryeredaktori ndihmon kryeredaktorin në udhëheqjen e redaksisë dhe mund të zëvendësojë kryeredaktorin në takime të brendshme dhe për të siguruar që procesi editorial të vazhdojë pa ndërprerje.
2. Zëvendës kryeredaktori merr pjesë në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të artikujve që do të përfshihen në numrat e Revistës.

## **Neni 11** **Sekretari i Redaksisë**

1. Përgjegjësitë e Sekretarit të redaksisë janë:
  - 1.1 Është përgjegjës për administrimin e korrespondencës, menaxhimin e dokumenteve dhe koordinimin e takimeve të redaksisë,
  - 1.2 Menaxhimi i arkivit të materialeve të Rrvistës,
  - 1.3 Komunikimi me autorët dhe partnerët e jashtëm.

## **Neni 12** **Bashkëpunëtorët profesionalë dhe shkencorë të Revistës**

1. Bashkëpunëtorët profesionalë dhe shkencorë janë trupa konsulente ku përfshihen ekspertë të njohur vendor dhe ndërkombëtar të fushave të ndryshme të stomatologjisë, kërkues shkencorë, profesorë universitarë, ekspertë të shëndetit publik, si dhe profesionistë të tjerë që mund të kontribuojnë në përmirësimin e përmbajtjes shkencore dhe profesionale të Revistës.
2. Bashkëpunëtorët profesionalë dhe shkencorë mund të angazhohen si recensentë për të vlerësuar dhe shqyrtuar artikujt e dërguar nga autorët, duke siguruar që përmbajtja e artikujve të jetë shkencore/profesionale e saktë dhe e besueshme.
3. Ata duhet të japin sugjerime për përmirësimin e artikujve dhe të sigurojnë që ato të përmbushin standardet profesionale dhe etike të stomatologjisë.
4. Bashkëpunëtorët profesionalë dhe shkencorë të Revistës mund të jenë specialistë të fushave të ndryshme të stomatologjisë, kërkues shkencorë, profesorë universitarë, ekspertë të shëndetit publik, si dhe profesionistë të tjerë që mund të kontribuojnë në përmirësimin e përmbajtjes shkencore dhe profesionale të Revistës.
5. Bashkëpunëtorët profesional përzgjedhën nga botuesi dhe kryredaktori i Revistës.

## **KAPITULLI III**

### **REVISTA**

## **Neni 13** **Struktura dhe përmbajtja**

1. Revista botohet dy herë në vit, në formë të shtypur dhe elektronike.
2. Përzgjedhja dhe renditja e përmbajtjes së numrit të Revistës bëhet nga Redaksia.
3. Redaksia refuzon dorëshkrimet që janë jashtë qëllimit të Revistës.
4. Revista botohet në gjuhën shqipe, duke mos përfshirë edhe gjuhën angleze.

5. Pjesët përbërëse të Revistës janë:
  - 5.1 Artikuj profesionalë e shkencorë
  - 5.2 Artikuj revialë
  - 5.3 Prezantim rasti
  - 5.4 Vështrim profesional
  - 5.5 Kumtesë e shkurtër
  - 5.6 Portreti i stomatologut
  - 5.7 Hapësirë promovuese
  - 5.8 Të ndryshme
6. Artikujt duhet të shkruhen sipas Udhëzimeve për autorin që hartohen nga Redaksia.
7. Redaksia e ruan të drejtën për ndryshime të përmbajtjes së Revistës.
8. Botimi i Revistës në formë të shtypur dhe elektronike bëhet nga botuesi i kontraktuar nga Oda.
9. Pas vlerësimit të përmbajtjes së materialit nga Redaksia, ajo i dorëzohet botuesit të kontraktuar për përgatitjen e formës përfundimare të numrit të ri të Revistës. Botuesi e përgatit formën për botim dhe i kthehet Redaksisë për miratim.

## **Neni 14**

### **E drejta për publikim**

1. Çdo profesionist i stomatologjisë dhe i fushave të tjera mjekësore ka të drejtë botimi në Revistë, me kusht që dorëshkrimi të jetë në interes të stomatologëve dhe pacientëve.
2. Redaksia përkrah dorëshkrimet dhe materialet që përmbajnë debate shkencore të bazuara në fakte, i vlerëson ato dhe vendos për publikimin e tyre.
3. Autori ka të drejtën e kontrollit dhe të përmirësimit të artikullit të tij para botimit.
4. Informacioni dhe opinionet e përfshira në artikujt e Revistës reflektojnë pikëpamjen e autorit dhe jo të Redaksisë apo të Botuesit të Revistës. Publikimi në vetvete nuk të thotë që revista ka të njëjtin qëndrim apo mban përgjegjësi për përmbajtjen e artikullit.
5. Autori mban përgjegjësinë juridike mbi pronësinë intelektuale të dorëshkrimeve dhe materialeve të dërguara për botim në Revistë.

## **Neni 15**

### **Hapësira promovuese**

1. Revista ofron hapësirë promovuese për reklamimin e aktiviteteve dhe produkteve të kompanive të ndryshme.



2. Përmbajtja promovuese vendoset në Revistë sipas marrëveshjes së Redaksisë me kompaninë promovuese.
3. Çmimorja për hapësirën promovuese përgatitet nga Redaksia e Revistës dhe miratohet nga KD.

## **Neni 16**

### **Koordinatori administrativ i Revistës**

1. Redaksia mbështetet nga koordinatori administrativ i Revistës.
2. Koordinator i Revistës nga radhët e Shërbimit Profesional të Odës caktohet nga Kryetari i OSK-së. Ai do të jetë në komunikim të vazhdueshëm me Kryeredaktorin dhe merr pjesë në planifikimin, organizimin dhe përmbushjen e detyrave të dala nga Redaksia.

## **Neni 17**

### **Arkivimi**

1. Për arkivim të numrave të botuar dorëzohen format elektronike dhe nga 5 ekzemplarë të shtypur në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe Bibliotekën e Odës.
2. Përgjegjës për arkivim të Revistës është Sekretari dhe Koordinator administrativ i Revistës.

## **Neni 18**

### **Buxheti**

1. Revista botohet nga buxheti i Odës, fondet e gjeneruara nga hapësira promovuese dhe donacionet.
2. Të hyrat nga hapësira promovuese dhe donacionet derdhen në xhirollogarinë e Odës me destinacion për Revistën.
3. Redaksia i raporton një herë në vit KD-së t për realizimin e mjeteve buxhetore të Revistës.
4. Lartësia e mëditjeve të anëtarëve të Redaksisë si dhe e ekspertëve të angazhuar bëhet në përputhje me aktet normative të Odës.

## Neni 19

### Mbikëqyrja e punës së Redaksisë

1. Redaksia për punën e saj i përgjigjet KD.
2. Redaksia i raporton me shkrim KD-së për çdo numër të botuar të Revistës.
3. Raporti i punës së Redaksisë i dorëzohet KD-së jo më larg se 2 muaj nga botimi i numrit të Revistës.

## Neni 20

### Hyrja në fuqi

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdeset Redaksia.
2. Për çdo çështje që nuk trajtohet në këtë rregullore, Redaksia i drejtohet për plotësim-ndryshimi KD-së.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OSK-së.



Kryetari i Odës së Stomatologëve të Kosovës

Prof. Dr. Blerim Kamberi